



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 787 Prot.

Shkodër, më 19.02 2026

V E N D I M

Nr. 71, datë 19.02 2026

"PËR MIRATIMIN E ZHVILLIMIT ONLINE TË PROCESIT MËSIMORË PËR SEMESTRIN E DYTË TË VITIT AKADEMIK 2025-2026, NGA PEDAGOGIA DR. BUJANË TOPALLI"

Mbështetur në Ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 15; Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38; Statuti i USH-së, neni 17; Vendim nr. 568, datë 6.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Kreu II, pika 14; referuar kërkesës së pedagoges, miratuar dhe përcjellë nga Departamenti i Psikologji dhe Punës Sociale, me shkresën nr.22 prot, datë 18.02.2026, paraqitur pranë Senatit Akademik, me lëndë: "*Kërkesë për zhvillimin online të procesit mësimor nga pedagogia Dr.Bujanë Topalli*", pasi u shqyrtua kërkesa dhe u vlerësuan kushtet e rrethanat objektive që pengojnë zhvillimin me prezencë fizike në auditor të pedagoges, provuar nga dokumentacioni shëndetësor dhe nevojës për trajtim e rehabilitim fizik afatgjatë, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 19.02.2026, në mënyrë unanime,

V E N D O S I:

1. Lejimin e zhvillimit të procesit mësimor online, për semestrin e dytë të vitit akademik 2025-2026, nga pedagogia Dr.Bujanë Topalli, si rast përjashtimor dhe për arsye objektive shëndetësore fizike, që pengojnë prezencën e saj në auditor.
2. Zhvillimi online i procesit të mësimdhënies do të kryhet nëpërmjet platformës zyrtare "Microsoft Teams".
3. Autoritetet kompetente, sipas kompetencave të dhëna nga Legjislacioni i Arsimit të Lartë në fuqi, të marrin të gjitha masat për ushtrimin e mbikqyrjes dhe kontrollit të realizimit të punës në distancë, për periudhën e miratuar.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zv/rektori akademik, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Departamenti i Psikologji dhe Punës Sociale, Drejtoria e IT-së dhe Znj. Topalli.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet deri në përfundim të semestrit të dytë të vitit akademik 2025-2026.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tomir GJURAI

